

VENDIM
Nr. 42, datë 27.11.2015

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR DISA PROJEKTE TË PROGRAMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, PJESE E FONDIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE,
PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për disa projekte në vazhdim, me cikël financimi 2014–2015, për programin e infrastrukturës vendore dhe rajonale, specifikuar sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.

Tabela 1. Projektet në vazhdim, infrastruktura vendore, me cikël financimi 2014–2015

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i objektit	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)
		QARKU ELBASAN			
1	Bashkia Gramsh	Sistemimi dhe asfaltimi lagjja “Sporti 1”, sheshi afër Tregut	27,766,813	23,139,044	4,627,769
		QARKU BERAT			
2	Bashkia Berat	Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit kryesor	36,941,510	7,097,244	29,844,266
3	Bashkia Berat	Projekti i urës me parmakët e gurit dhe ndriçimi, Berat	57,830,323	5,919,903	51,910,420
4	Bashkia Berat	Vazhdimi i rikonstruksionit të lulishtes perëndimore (Loti opsional) dhe	59,835,384	5,991,893	53,843,491

		suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka” (Loti 3 pjesor), Berat			
5	Bashkia Berat	Kulla e Sahatit	4,035,786	499,790	3,535,996
6	Bashkia Ura Vajguore	Pedonale e Urës Vajguore	41,753,197	6,129,027	35,624,170
	TOTALI		228,163,013	48,776,901	179,386,112

Shënim:

1. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoritetit kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).

2. “Vlera e financimit”, për vitin 2014, tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2014, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objektit.

3. “Vlera e financimit”, për vitin 2015, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit për vitin 2014.